



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 18-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 28.06.2019 (e premte), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 14. Muhamet Ukaj, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 21. Labinot Alijaj, PDK; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 22. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Riza Dreshaj, LDK; | 23. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Ruzhdi Metaj, LDK; | 24. Radoš Repanović, SL; |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 25. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | 26. Slaviša Maliković, SM. |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari z.Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, medieve, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit hapi punimet për mbledhjen e 18-të e Legjislacionit të VI-të. Për këtë mbledhje propozon këtë rend dite.

Rendi i ditës

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore KAB 2020-2022;
4. Shpallja në diskutim publik i Plotësim-ndryshim Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në komunën e Istogut;
5. Shpallja në diskutim publik i Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit ;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës më prona private dhe
7. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kuvendi në mënyrë unanime, miratoi rendin e ditës për këtë mbledhje.
Në procedurën e votimit nuk mori pjesë: Agron Avdijaj.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi, njoftoi se për këtë mbledhje mungon: Agron Avdijaj. Gjithsej në mbledhje janë të pranishëm 26 (njëzetë e gjashtë) këshilltarë.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi, vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A ka dikush diçka lidhur me këtë procesverbal?

Slaviša Maliković, unë me këtë pikë të rendit të ditës nuk pajtohem aspak sepse në procesverbalin e mbledhjes së kaluar shkruan se unë kam votuar për, ndërsa unë kam abstenuar në të gjitha pikat.

Kryesuesi, mundësisht na shenoni së në cilat pika keni qenë i permbajtur dhe ne e kemi llogaritur gabim.

Haki Podrimaj, përshëndeti të pranishmit, te rekomandimet pika 8 është një propozim për projektin: "Ndërtimi i Trotuarit nga Bajica, rruga e Banjës deri të varrezat e Carallukës e jo "Studenices". Kërkoj të përmirësohet, në vend të "Studenice" të shënohet "Carallukë".

Kuvendi në mënyrë unanime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar, më vërejtje.

Obligohet shërbimi për punë të kuvendit që të përmirësoj procesverbalin e mbledhjes së kaluar më vërejtjet që ka dhënë Slaviša Maliković. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Radoš Repanović dhe Radenko Belošević.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi- vazhdon me pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore KAB 2020-2022 , lidhur me këtë pikë fjalën ia kalon Kryetarit.

Kryetari, përshëndeti të pranishmit. Shkurt do të ndalem të korniza është mbajtur edhe tubim me qytetar. Dua të them një gjë, me qenë se është kornizë duhet edhe t'i shikojmë kufijtë buxhetor dhe në fazën e ardhshme duhet të eliminohen shumë prej propozimve. Këto janë projekte të propozuara nga drejtoritë komunale, qytetarët. Gjithsesi jemi të detyruar të bëjmë ndryshime dhe kufizime mirëpo do të bëjmë përpjekje të jemi korrekt dhe t'i gjejmë ato që janë prioritete të duhura pa dallime. Pa kënaqësi do të ketë gjithmonë por do të bëjmë përpjekje që të zgjidhen ato që janë më të dobishme për juve, ne dhe gjithë qytetarët e Istogut.

Osman Sadikaj, përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi Kornizën Afatmesme Buxhetore KAB 2020-2022. Kërkoj falje që me vonesë janë ardhur propozimet e KPF-së dhe janë futur sot. Tani e keni materialin e kompletuar ngase dje e kam parë se nuk janë përfshirë edhe ato propozime. Mund të propozoni edhe ju çdo njëri ndonjë projekt që nuk është këtu dhe dëshironi më përfshi në kornizë. Të gjitha projektet do të behën bashkë dhe i dergojmë në ministri dhe pastaj vjen dokumenti tjetër dhe e finalizojmë. E kemi bërë këtë listë dhe për donacione, mundemi për të apliku dhe perfitu pasi kjo miratohet edhe në kuvend.

Naim Imeraj, falënderon për fjalën dhe përshëndeti të pranishmit. Është Korniza afatmesme buxhetore e parë, kështu u sqaru edhe nga ZKF. Për mua po krijohet një dileme pavarësisht që në mënyrë tërthore Kryetari i komunës e tha por prapë se prapë te shpenzimet kapitale nëse e marrim këtë 11milion e 461mijë, edhe i heqim kategorit përpos shpenzimeve kapitale na mbetet që kemi në këtë fazë buxhet prej 3milion e 210mijë. Ne e kemi një list të prioriteteve e cila është dyfishi i saj, kisha dashtë me u sqaru në këtë fazë a është listë e dëshirave apo listë e mundësive? Edhe ky paralajmërim i kryetarit që eventualisht reduktimet në projekte do të mund të krijojnë pakënaqësi a lidhet me këtë element financiar, me këtë element të pa precizuar financiar? Përndryshe nëse e marrim këtë 6 milion e 188 mijë që paska ardhur në verzionin e fundit, buxheti del 40 milion e gjysmë. Dua të di a jemi në mundësi që me ardhur te 6 milion shpenzime kapitale siç i kemi planifiku apo ndërkohë ndoshta fazat vijuese të dëgjimeve buxhetore në nivelin qendror edhe të dëgjimeve buxhetore të shqyrtimeve tona këtu në kuvendin komunal, do ta reduktojnë këtë në të njejtën masë, kur e di se zakonisht ndryshon. Por jo në masën e dyfishtë, pa pretendime me u futur në listën e projekteve kapitale se në çfarë do

rrethanash, çka do që fusim këtu prapë se prapë nevojat e qytetarëve janë që me pas ende. Mirë kishte me qenë që me u përfshi vullneti edhe kërkesa e të gjithëve por jo pa mbulesë financiare. Nuk e kam dilemen që si kuvend i komunës nuk do ta bëjmë maksimumin që me ardhë te ai kuorum i cili është satisfaksion për vitin 2020. Së paku edhe pse kjo është kornizë afatmesme e përfshinë edhe dy vitet tjera por e di që në çdo vit rikthehem kur bëhët planifikimi i buxhetor rikthehem prapë të viti aktual edhe ato dy vitet pasuese janë gati për vitin tjetër, përpos rasteve që egziston naj projekt që e ka përshkrimin buxhetor shumë vjeçar. Kaq kisha për këtë fazë dhe faleminderit për fjalën kryesues.

Osman Sadikaj, unë e thash edhe në fillim kjo është identifikim i prioriteteve, pastaj vjen qarkorja më kufijtë. Kur vjen qarkorja atëhere kish qenë mirë mos me dalë jashtë kufijve buxhetor. Kështuqë kufijtë financiar këtu mos t'i marrim brenda çarkut, se mund të jetë ndoshta ndonjë projekt i cili është jashtë burimeve të financimit ose mundë të jenë nga burime të sigurta financiare, prandaj nëse keni ndonjë projekt që keni me shtu jashtë kësaj urdhëroni, qëllimi është që mos të dalim jashtë kornizës.

Arben Kabashi, përshendeti të pranishmit, po shohim se çdo ditë kërkesat po rriten. Do ishte më mirë të merem me atë se si të krijohen kushtet që të hapen vende të punës po ashtu edhe bizneset të reja. Por prap se prap nuk po mundemi me ju ik kërkesave të qytetarëve të cilat janë të shumta për kanalizime e të tjera. Mua më kanë ardhur disa propozime dhe kësaj radhe do të tregohem lokalist. Propozim kam edhe nga fshati Kovragë. Ne çdo herë shkojmë aty dhe e rekalamojmë mollën, dy rrugë kryesore në lagjen "Haxhijaj" dhe "Bekaj" janë të paasfaltuara dhe të paplanifikumë në këtë kornizë. Rruga quhet Rruga "Fushëkuqe". Kam propozime edhe nga fshati Kaliqan, kanë kërkuar "Urë që lidh fshatin më varreza", "Ndërtimin e trotuarit tek shkolla në Kaliqan", "Ndërtimi i kanalizimit në Kaliqan-Lagjia Osmanaj". Tani do të ndalëm në Gjurakoc, "Rrënimin e objekteve të vjetra në Komunën e Istogut", "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Gjurakoc". Gjithashtu janë planifikuar 80 mijë euro për rrugë në Gjurakoc por rruga më e nevojshme është Rruga "Smajl Metaj", po ashtu Rruga "Daut Bajramaj" dhe një propozim "Betonimi i kanalit të ujitjes në Gjurakoc", Lagjia "Kabashi".

Arif Elshani, përshëndeti të pranishmit, propozoj që të ndahet një shumë për "Rrethimin e varrezave në Staradran".

Muhamet Ukaj, propozoj "Rregullimin e shtratit të përroit vërshues në Kaliqan" dhe "Rregullimi i varrezave dhe vendosja e një pallkë përkujtimore për të vrrarët në Kaliqan".

Mirushe Sadikaj, përshendeti të pranishmit dhe propozoi "Ndërtimin e rrugës prej rrugës kryesore deri të varrezat e reja në Studenicë". Dy pyetje, ku do të ndërtohet tregu i ri që është paraparë me vlerë prej 100 mijë euro, edhe tregu ditor. Po ashtu

dy pyetje nuk kanë të bëjnë me këtë kornizë buxhetore mirëpo mbase janë drejtorat këtu kishin me mu përgjigj për projekte kapitale. Të gjitha projektet që janë paraparë kisha dashtë që të përfundojnë me kohë do të thotë është paraparë që të ndërtohet trotuari në Studenicë dhe nuk ka filluar ende poashtu rruga e bjeshkës që është paraparë për këtë vit edhe po kanë probleme. Ajo rrugë është paraparë vitin e kaluar dhe janë ndarë 60 mijë euro edhe diçka tjetër, projekti i rrugës së bjeshkës nuk na kërkon për participim, pse tash po ndodhë, kush ka jep urdhër?

Labinot Alijaj, përshëndeti të pranishmit. Unë kërkoj një sqarim prej drejtorit të kulturës për planifikim e dekorimit të qytetit, planifikim për përkrahje të rinisë "Dekorim i qytetit me drita vezulluese", vlera 10.000 mijë euro. Kërkoj një sqarim për këtë pikë. I kam edhe tri ose katër propozime nëse me lejohet se a përfshihen a jo mbetet tek ju. Kërkoj që brenda qytetit të Istogut të ndërtohen dy ose tri kënde për lojra të fëmijëve që është mungesë në qytetin tonë. Kërkoj në fshatin Shushicë e ulët, "Rrjetin e ujrave të zeza për lagjen Metaj, Jahaj, Nekaj, Nimanaj, Selmanaj edhe Alijaj". "Asfaltimi i Rrugës "Nimon Sadrijaj" në Shushicë te ulët", edhe kisha pas dëshirë ose e kisha mor si sqarim këtë pikë prej drejtorit të financave ose prej kuj këtu a kish pas mundësi. Që të ndahet një pjesë e buxhetit të specifikohet për subvencionim të sportistave të cilët lëndohen edhe i kushtojn koga shumë operimet e tyre si në rastin e ligamenteve e të tjera, kështu që kisha kërku si sqarim me marrë këtë.

Eliot Kukiqi, përshëndeti të pranishmit. E diskutuam rrugën "Xhafer Mehmetaj" në Gurrakoc, a ka mundësi që kjo rrugë në tabelen e finalizimeve të projekteve kapitale të emërohet për vitin 2020, të shënohet emri aty dhe mos me mujt me hek prap.

Zenel Shatri, përshëndeti të pranishmit, nuk po e shohw, ka qenë përpara "Rregullimi i lumit Shushicë-Kovragë-Tomoc" dhe e dijmë që është shumë e nevojshme sepse që është rregullu vetëm në Tomoc. Vitin e kaluar ka qenë dhe është paraparë ndërsa tash nuk po e shohë, mendojë që është e domosdoshme të futet në kornizen afatmesme buxhetore.

Naim Behlulaj, përshëndeti të pranishmit. Në radhë të parë ju falënderojë për punën që keni bërë deri më tani sa i përket pjesës së mbi vadës edhe në gjithë komunën e Istogut. Une i kam disa propozime të cilat besojë që janë me vend kërkojë nga Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, të futen rrugicat apo rrugët në Lagjen Imeraj, ku i kem edhe dëshmorët që vin prej asaj pjesë në Padalishtw. Kërkoj që kjo të hyjë në kornizwn afatmesme buxhetore, ndërsa te drejtoria e bujqësisë, kërkoj të futet "Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Uçë", e përfshinë edhe Rakoshin. Ndërsa në lagjen Sadikaj në fshatin Shushicë të futet "Ndërtimi i kanalit për mbrojtjen e rrugës", ndërsa te rinia e kam kërkuar edhe më herët njw "Qënder rinore" kur do që të jetë e mundshme le të jetë aty.

Nexhmedin Balaj, përshëndeti të pranishmit, unë e kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Çfarë po bëhet më një kanalizim në Lluga?

Ajshe Metaj, përshëndeti të pranishmit, unë paraprakisht dashta me u konsultu me Zyrтарin kryesor financiar, ato projekte që i kemi propozu në KPF, unë nuk po i gjej këtu.

Kryesuesi, Ajshe ka qenë një gabim teknik dhe tash i keni aty ato materiale.

Ajshe Metaj, unë e kam një kërkesë, për këto gratë asambleiste se kemi mbetë pa i përfundu disa aktivitete se nuk po kemi mjete.

Kuvendi me 23 vota për, pa vota kundër dhe pa abstenime miratoi Kornizën Afatmesme Buxhetore KAB 2020-2022 më propozimet e KPF dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi, vazhdon me pikën e katërt, shpallja në diskutim publik i Plotësimndryshim Rregullores komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në komunën e Istogut. Mendoj se kemi kohë dhe nëse nuk keni diçka po e percjellim në diskutim publik.

Fjalën ja kaloi Arben Kabashit.

Arben Kabashi, kryesues sa here që kemi diçka për të shpall në diskutim publik, te kalojmë.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime shpall në diskutim publik Projekt-Rregulloren për komunale për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Istogut.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Riza Dreshaj, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi- vazhdon me pikën e pestë të rendit të ditës, shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit. Edhe kwtu kemi të bëjme me shpallje në diskutim publik. Fjalën ja kaloi Edona Bujupi-Loxhes, Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë Komunale.

Edona Bujupi-Loxha, përshëndeti të pranishmit, jemi në pikën e rendit të ditës: shpallja në diskutim publik e Projekt-Rregullores për transparencë dhe Plani i punës së veprimit. Sot nuk ishim lëshu në komente pasi që ka me kalu në diskutim publik.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime shpall në diskutim publik Projekt-Rregulloren për transparencë dhe Plani i punës së veprimit.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Shqyrtimi i pikës 6

Kryesuesi, vazhdon me shqyrtimin dhe miratimin e pikës së gjashtë sipas rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës më prona private. Është obligim ligjor dhe duhet që për secilin propozim-vendim të votojmë veç e veç. Fjalën ja kaloi drejtorit Jashar Blakajt.

Jashar Blakaj, dua të ju njoftojë se kemi dy propozime, e para është rruga që njihet si Peja 3, Kërrninë, Belicë, Voilinë. Ky është një projekt me bashkfinancim të komunës dhe ministrisë. Ndërsa rasti i dytë është për një këmbim të pronës komunale për rrugë në Veriq, që do të këmbëhet me pronë private për shkak se kanë bërë kërkesë vet banorët, pronarët e tokave etj. Sepse është e pa kalur ajo rrugë, ka qenë kërkesë dhe vet komisioni ka dal në vendin e ngjarjes dhe nga aty ka konstatu se është e arsyeshme ajo kërkesë, pronari ka marr përsiper ta rregullojë rrugën që të jetë e kalueshme. Rasti i dytë tash në këtë rast është rruga për Gurakoc, rruga egzistuese pronë komunale vazhdon nëpër këtë pjesë ndërsa këmbëhet me pronën tjetër që vazhdon afër shkollës së Veriqit. Në të njëjtën parcellë pronari ka ofru këmbim prone me kushte më të mira, katër metra është gjërësia e rrugës ndërsa kjo është dy metra. Procedurat janë kryer, titullari i pronës e ka pranuar atë edhe e ka bërë nënshkrimin e asaj dhe tash ata të gjitha janë shumë të kënaqur që po ju bëhet kjo punë. Prona komunale i ka dikun pesë ari e keni edhe raportin ndërsa ka prona private do të ipen shtatë ari që do të thotë jo që është dëmtuar titullari i pronës mirëpo ai është i pajtimit sepse tani e ka një interes dhe rruga e ndan parcellen në mes.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.293/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.279/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.280/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.282/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.292/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.291/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.290/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.289/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.288/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.287/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.286/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.285/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.284/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.283/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Kuvendi me votim 21 për, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi Propozim-Vendimin 01Nr.281/19, të datës: 13.06.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës më pronë private.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë: Agron Avdijaj, Zenel Shatri, Arif Elshani, Radoš Repanović, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi- vazhdon me pikën e fundit të rendit të ditës, pyetje nga anëtarët e kuvendit komunal. Fjalën e ka kërkuar Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj, unë kam disa pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, pyetja e parë është deri ku ka levizë vendimi i kuvendit për subvencion? Pyetja e dytë, a është dal konkursi për bord të stacionit të autobusëve? Pyetja e tretë është një shqetësim i qytetarëve sidomos pjesës së mbi vadës, ku autobusët të cilët e kanë jë linjë Istog-Rakosh-Uçë, nuk e mbajnë këtë linjë dhe qytetarët janë të detyruar të ecin deri në Rakosh të kërkojnë taksi apo diçka. E kanë kerkuar dhe është viti 2019 dhe nuk është ndërmarr asgjë që të stacionohen këta së paku që të dalin me ndonjë kombi bus apo ta mbajn një linjë ashtu qysh duhet. Ndërsa drejtori i bujqësisë nuk është këtu deri ku ka shkuar mirmbajtja e rrugëve të bjeshkëve se tash veq hinem në muajin korrik edhe ta pak që janë në bjeshkë veq janë përgatit me ardhë poshtë nuk e di deri ku ka shku. Është shqetësim i atyre banorëve të cilët dalin në bjeshkë se pe shoh që shumë është prish rruga për këta dashta ta pyes drejtorin ndërsa te drejtori për arsim është kërku dhe na ka premtu që do ti ndaj 20mijë euro për Gjimnazin "Haxhi Zeka" për disa që duhet me i rregullu që janë në gjendje jo të mirë kështu qe a ka mujt me i ndarë ato mjete.

Kryesuesi- Fjalën e ka kërkuar Besa Ferati.

Besa Ferati, falenderon kryesuesin dhe përshendet të pranishmit. Unë së pari dashta me bërë një njoftim për ata që se kanë dëgjuar një nxënës i Komunës tonë Fisnik Kabashi në garat që janë mbajtë në nivel nacional për mendim kritik e ka nxënë vendin e parë në nivel vendi me ese hulumtuese, pyetja ime është a ka komuna ndonjë fond që i shpërblen këta nxënës apo ndanë ndonjë mirënjohje si shenjë simbolike për punën e tij. Nxënësi është i shkollës teknike "Mithat Frashëri".

Kryetari, nuk ka fond ekzakt për këtë punë mirëpo zakonisht i kemi shpërbly në forma të ndryshme, ku kanë marrë pjesë në gara ndërkombëtare që ka pas rast që i kemi ndihmu dhe janë shku në Argjentinë kemi raste të tilla dhe i shpërblejm mirëpo fond të caktum nuk ka.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Ardita Idrizaj.

Ardita Idrizaj, përshëndet të pranishmit, pyetje ish-nënkryetarit për rrugën në fshatin Lubozhdë që dy javë a tri me ka thanë që vi me e matë dhe nuk ka ardhur fare. Dashta me dit dikush nga ju a mundet me na jep përgjigje se kur do të fillojnë punimet në fshatin Lubozhdë-Lagjja Idrizaj.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Mirushe Sadikaj.

Mirushe Sadikaj, pasi qe drejtorat nuk qenkan sot këtu, pyetja ime e parë është, çka po ndodhë me trotuarin Vrellë-Studenicë, pse nuk ka fillu edhe për rrugën e bjeshkës po ka probleme? Dhe nuk e di pse po ndodhë kjo, edhe në raste kur shpërthen kanalizimi kush i mbanë këto shpenzime, se kam pasur probleme me qytetarë që ju ka ndodhë shpesh, këto punë që kryhen duhet të pranohen.

Kryesuesi, fjalën e ka kërkuar Jehona Haxhijaj.

Jehona Haxhijaj, përshëndeti të pranishmit. Unë dashta me u ndërlidh me Naim Behlulin, drejtorit po ja bëj të njëjtën pyetje, deri ku ka shkuar çështja e stacionit të autobusëve? Unë kam udhëtu të hënën dhe të martën për Prishtinë edhe e kam parë që një kompani nuk po e ceki me emer ka hy në stacion të autobusave dhe e ka kry obligimin e vet. U befasova se e pashë që ka fillu me funksionu diçka kështuqe unë kërkoj prej teje një përgjigje a veprojn edhe tjerat kompani ashtu apo është ajo e vetmja?

Labinot Aliaj, unë desha të pyes kryetarin për statusin e varrezave afër që janë. Në bazë të qytetarëve kam informacion që aty është kanë një leje për dhjetë vjetë dhe thuhet së është bërë rivarrim i tyre. A kanë ndonje status të veçantë, pse duhet me i ruajt ato?

Nexhmedin Balaj, pyetje për Enver Rugoven. Fshati Lluga kanalizim nuk kanë, disa kërkesa janë bërë.

Ajshe Metaj, përfundoj edhe ky vit shkollorë ndersa tenderi është fitu për lyerje dhe pastrimin e shkollave, kisha desht me bërë pyetje së çka ka ndodh ngase edhe prind nuk janë ndier mirë ?Dhe një pyetje, ne i kemi bërë disa aktivitete me gra kam pyetje se si mundem me i fitu subvencionet që më vazhdu aktivitetet dhe nga kush?

Kryetari, unë një gjë dua të ju them, kërkesat e kanë rëndësinë e vet dhe më shërbjenë mua shumë. Të gjitha pyetjet qe keni bërë i kam dëgjuar sigurisht edhe drejtorët përkatës. Kjo më shërben mua që akterve që janë në ngjarje të ju bëjë presione jo pse e ndijë vetën dobët por këta do të ndinë vetën më përgjegjës. Të çështja e varrezave aty është mar një vendim një herë më i zhvendos, këtu po flas në bazë të ish kryetarëve, me fjalë të të ndjerit Sejdi Kabashi. Që në atë kohë ka qenë kryetar komune, mirëpo të gjitha eshtrat nuk janë zhvarros mirëpo ndërkohë në vitet e 90-ta, këta që janë më të vjetër e mbajn mend aty iprovizonin kisha me letra dhe atëherë e kan anulë vendimin paraprak. Këtu është problemi që na nuk po mundemi me gjetë vendimin e atëhershëm fare, unë kam bërë kerkesë për atë vendim dhe kam kërkuar dialog me ta, përndryshe nuk mund ta zgjidhim më me klerin do të thotë me kishen ortodokse. Ne duhet të bëjmë diçka me këto varreza, mirëpo ata po hezitojnë se kanë frikë me i zhdukë gjurmët. Për këtë ata vetë kanë marr vendim dhe të njëjtën kohë i kanë rënë pishman. Nuk po kam dëshirë me marr një hap apo një veprim me të cilin dikush prej ndërkombëtarëve apo prej qeverie të ma ndalojë sepse nuk kam dëshirë të ma ndalojë.

Kryesuesi, duke ju falënderuar për pjesëmarrje në këtë takim dhe kontributin e dhënë e shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 12:00.

Procesmbajtëse,
Arlinda Kurtaj



Kryesues,
Qaush Balaj

